



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 19 Shkurt 2022

Nr: 86

V E N D I M

P Ë R

**SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË “RTSH SHKODRA”,
“EURO BALKANS NEWS”, “TV KLAN” dhe “MCN TV” PËR VËZHGIMIN E
ZGJEDHJEVE TË PJESSHME PËR KRYETAR BASHKIE, TË DATËS 6 MARS 2022**

Sot, më datë 19.2.2022, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi shqyrtoi kërkesën e:

KËRKUES:

- 1.“RTSH Shkodra”, me seli në Shkodër, Sheshi Demokracia 22 dhe përfaqësues z. Ergys Kavaja;
- 2.“Euro Balkans News shpk”, me seli në Tiranë, Rruga “Rezervat e Shtetit”, Lundër dhe përfaqësues z. Neritan Sejamini;
- 3.“TV KLAN sha”, me seli në Tiranë, Rruga “Alexandër Moisiu”, Nr. 97, dhe përfaqësues zj. Eglantina Lamaj
- 4.“MCN TV”, me seli në Tiranë dhe përfaqësues zj. Marsida Karabollaj.

OBJEKTI:

Kërkohet akreditimi si vëzhgues i gazetarëve dhe operatorëve për vëzhgimin e zgjedhjeve të pjesshme për kryetar bashkie të datës 6 Mars 2022.

BAZA LIGJORE:

Nenet 6, 7, e 19, pikat 1, shkronja “n”, e 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe Udhëzimit nr.2, datë 02.02.2021 “Për procedurat e akreditimit dhe rregullat e vëzhgimit të zgjedhjeve nga organizatat joqeveritare shqiptare dhe të huaja, organizatat ndërkombëtare, përfaqësues të shteteve të huaja, mediave dhe subjektet zgjedhore”,



VËREN:

“RTSH Shkodra” i ka paraqitur Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën si dhe dokumentacionin përkatës për akreditimin e 18 (tetëmbëdhjetë) gazetarëve dhe operatorëve, si dhe zonat e vëzhgimit të tyre. Kërkesa e paraqitur respekton afatin kohor të përcaktuar në nenin 6, pika 5, të Kodit Zgjedhor. “RTSH Shkodra” është subjekt i cili gëzon të drejtën të caktojë vëzhgues në zgjedhje të përcaktuar në nenin 6, pika 2, të Kodit Zgjedhor.

“Euro Balkans News shpk” i ka paraqitur Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën si dhe dokumentacionin përkatës për akreditimin e 34 (tridhjetë e katër) gazetarëve dhe operatorëve, si dhe zonat e vëzhgimit të tyre. Kërkesa e paraqitur respekton afatin kohor të përcaktuar në nenin 6, pika 5, të Kodit Zgjedhor. “Euro Balkans News shpk” është subjekt i cili gëzon të drejtën të caktojë vëzhgues në zgjedhje të përcaktuar në nenin 6, pika 2, të Kodit Zgjedhor.

“TV KLAN sha” i ka paraqitur Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën si dhe dokumentacionin përkatës për akreditimin e 36 (tridhjetë e gjashtë) gazetarëve dhe operatorëve, si dhe zonat e vëzhgimit të tyre. Kërkesa e paraqitur respekton afatin kohor të përcaktuar në nenin 6, pika 5, të Kodit Zgjedhor. “TV KLAN sha” është subjekt i cili gëzon të drejtën të caktojë vëzhgues në zgjedhje të përcaktuar në nenin 6, pika 2, të Kodit Zgjedhor.

“MCN TV” i ka paraqitur Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën si dhe dokumentacionin përkatës për akreditimin e 18 (tetëmbëdhjetë) gazetarëve dhe operatorëve, si dhe zonat e vëzhgimit të tyre. Kërkesa e paraqitur respekton afatin kohor të përcaktuar në nenin 6, pika 5, të Kodit Zgjedhor. “MCN TV” është subjekt i cili gëzon të drejtën të caktojë vëzhgues në zgjedhje të përcaktuar në nenin 6, pika 2, të Kodit Zgjedhor.

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në nenet 6, 7, e 19, pikat 1, shkronja “n”, e 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe udhëzimin nr. 2, datë 2.2.2021 “Për procedurat e akreditimit dhe rregullat e vëzhgimit të zgjedhjeve nga organizatat joqeveritare shqiptare dhe të huaja, organizatat ndërkombëtare, përfaqësues të shteteve të huaja, mediave dhe subjektet zgjedhore”, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

V E N D O S I:

1. Akreditimin si vëzhgues për vëzhgimin e zgjedhjeve të pjesshme për kryetar bashkie të datës 6 Mars 2022, të 18 (tetëmbëdhjetë) gazetarëve dhe operatorëve të Medias “RTSH Shkodra”, sipas listës së përcaktuar në lidhjen 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Akreditimin si vëzhgues për vëzhgimin e zgjedhjeve të pjesshme për kryetar bashkie të datës 6 Mars 2022, të 34 (tridhjetë e katër) gazetarëve dhe operatorëve të Medias “Euro Balkans News shpk” sipas listës së përcaktuar në lidhjen 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
3. Akreditimin si vëzhgues për vëzhgimin e zgjedhjeve të pjesshme për kryetar bashkie të datës 6 Mars 2022, të 36 (tridhjetë e gjashtë) gazetarëve dhe operatorëve të Medias “TV KLAN sha”, sipas listës së përcaktuar në lidhjen 3, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
4. Akreditimin si vëzhgues për vëzhgimin e zgjedhjeve të pjesshme për kryetar bashkie të datës 6 Mars 2022, të 18 (tetëmbëdhjetë) gazetarëve dhe operatorëve të Medias “MCN TV” sipas listës së përcaktuar në lidhjen 4, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
6. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 24 (njëzet e katër) orëve nga shpallja e tij, në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

